



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 84-të, të mbajtur më 31.03.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-3139/1 të datës 09.09.2020, me pretendime për mosveprim të organeve kompetente sipas denoncimeve për ngacmime dhe ndërtime të paligjshme, **HIDHET POSHT**.

KSHPK-ja përcaktoi se në përputhje me ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka kompetencë për veprim në rastin e lëndës

Lënda me numër 12-3139/1 të datës 09.09.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Më datë 09.09.2020, një parashtrues i njohur ka dorëzuar denoncim me pretendime për mosveprim nga organet kompetente pas raportimeve për ngacmime dhe ndërtime pa leje dhe është konstatuar rasti me numër 12-3139/1, datë 09.09.2020.

Në denoncim parashtruesi thekson se dy familje banuese në rr. /// nr./// ///, janë ngacmuar në disa raste nga fqinji /// me të cilin kanë pasur keqkuptime në lidhje me veprimet që ai ka kryer në pronën e tyre gjatë ndërtimit të një shtëpie për të cilën parashtruesi ka deklaruar në kërkesë se është ndërtuar ilegalisht në vendin e një shtëpie të vjetër që ai e kishte blerë më parë.

Siç thuhet në raport, përfaqësuesit e familjeve që jetojnë në ul. /// nr./// /// rasti tashmë është raportuar te kryetari i komunës ///. Njëkohësisht, në denoncim thuhet se në vendngjarje ka dalë një inspektor i autorizuar ndërtimor, por veprimet e organeve kompetente nuk kanë pasur efekt për shkak të pretendimit të ushtrimit të ndikimit nga fqinji ///.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arriti në përfundimin se denoncimi përmban pretendime të përgjithshme, pa specifikuar zyrtarë konkretë, dhe në të njëjtën kohë, bëhej fjalë për pretendime për një çështje që nuk është në kompetencën e KSHPK-së, pas së cilës ka konstatuar se nuk ka juridiksion për trajtimin e çështjes në fjalë.

Duke pasur parasysh të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- parashtresesi i denoncimit

përpiloi: A.R.M.

Miratoi: S:P:D., anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDLAIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar,
Katica Nikolovska**

